



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 141, Datë 15.06.2021

MBI

MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË
VLERËSIMIT DHE TË PËRZGJEDHJES SË FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË
FUNDIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, VKM nr. 449, datë 15.06.2016, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”, nenit 26, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.06.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr.89/1 prot., datë 09.06.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi “Miratimin e rregullores për përcaktimin e kritereve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit, në Sektorin e Energjisë Elektrike”,

Konstatoi se:

- Në nenin 87, pika 2, të ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikohet se: ERE, bazuar në kushtet e përcaktuara sipas pikës 1, të këtij neni, cakton furnizuesin e mundësisë së fundit.
- Këshilli i Ministrave me VKM nr. 449, datë 15.06.2016, ka vendosur “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”. Në seksionin III, të VKM-së nr. 449, datë 15.06.2016, Këshilli i Ministrave ka vendosur se: *deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas këtij vendimi, ERE cakton përkohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e furnizuesit të mundësisë së fundit.*
- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 115, datë 08.07.2016, “Mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”, dhe në vijim me vendimin Nr. 96, datë 4.7.2017, mbi shtyrjen e afatit të vendimit të ERE-s Nr. 115, datë 7.8.2016, "Mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike", është vendosur *përkohësisht OSHEE sh.a., në cilesinë e Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të kryer detyrat e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike, nga data 1 korrik 2016, deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016.*

- 2. Në rastet kur klienti nuk arrin të sigurojë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit, furnizimi si mundësi e fundit kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 449, datë 15.06.2016”.
- Bordi i ERE-s me anë të vendimit nr. 131, datë 10.08.2020, vendosi: “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit në sektorin e energjisë elektrike”.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar dhe u njoftuan palët e interesit që brënda 20 ditëve të shprehnin opinionin e tyre me shkrim.
- Në përfundim të afateve për pritjen e komenteve të palëve të interesit rezultoi se vetëm shoqëria FTL sh.a. ka përcjellë në ERE shkresën e saj me komente e sugjerime në lidhje me këtë rregullore.
- Sugjerimet e FTL sh.a. për përshtatjen e termave dhe përkufizimeve të kësaj rregulloreje në një gjuhë më të thjeshtë dhe të qartë janë vlerësuar të drejta dhe janë reflektuar në rregullore.
- Sugjerimet e FTL sh.a. për përjashtimin nga kjo rregullore të disa nga kriterëve të përcaktuara në VKM Nr. 449, datë 15.06.2016, nuk u vlerësuan të drejta e nuk janë pranuar.
- Sugjerimet FTL sh.a. për përthithjen e dispozitave të vecanta të kësaj rregulloreje, në një dispozitë të vetme janë pranuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit në Sektorin e Energjisë Elektrike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI